


- Ndërmjetësuesit**

 - krijojnë një marrëdhënie besimi dhe komunikimi të hapur me përfaqësuesit e palëve;
 - përpiqen të kuptojnë situatën në mënyrë që të reflektojnë pikëpamjet e perspektivës dhe bazën për opinionet, ndjenjat, qëndrimet dhe veprimet;
 - krijojnë kontakt ndërmjet palëve duke siguruar një komunikim efektiv;
 - lehtësojnë dhe/ose përforcojnë komunikimin dhe marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve rome dhe institucioneve publike (arsimore, shëndetësore dhe punësimi).
- Pika Kombëtare e Kontaktit:**

 - mbështet ndërmjetësuesit për të kryer aktivitete praktike në intervalin gjashtëmuor nga njëri sesion trajnimi tek tjetri;
 - mbështet Këshillin e Evropës në procesin e monitorimit;
 - i ofron mendime skuadrës së trajnerëve për platformën online, për të ndihmuar në organizimin e sesioneve të trajnimit;
 - informacion për aktivitetet kombëtare gjatë periudhës së zbatimit



Ndërmjetësimi ndërkulturore për komunitetet Rome (ROMED)

Veprim i përbashkët i Këshillit të Evropës dhe i Komisionit Evropian

Programi ROMED përfiton nga ndihma financiare e qeverive të Finlandës, Francës, Gjermanisë, Qipros, Serbisë, Spanjës dhe Shqipërisë

Për më shumë informacion
Këshilli i Evropës
Skuadra e Përfaqësuesit të Sekretarit të përgjithshëm për Çështjet Rome
F-67075 Strasbourg Cedex
www.coe.int/rom
Drejtuues Projekti
Aurora Ailincăi
aurora.ailincai@coe.int

PREMS 270112 ALB

Financé par l'Union Européenne et le Conseil de l'Europe



Mis en œuvre par le Conseil de l'Europe

Pikat e nisjes: fakte dhe sfida

Ndërmjetësimi është një ndër masat e përdorura në të gjithë Evropën për të trajtuar pabarazitë me të cilët hasen romët për sa i përket punësimi, shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe arsimit cilësor. Ai është një proces që përfshin punësimin e njerëzve me lidhje me romët, nga komunitetet rome, ose me njohuri të mirë mbi çështjet rome për të vepruar si ndërmjetësues ndërmjet romëve dhe institucioneve publike.

Shumëllojshmëri situatash dhe detyrash

Ndërmjet vendesh të ndryshme ekzistojnë dallime të shumta qoftë për sa i përket situatës dhe nevojave të komuniteteve rome në terminologjinë e përdorur, në nivelin në të cilin ndërmjetësuesit janë punësuar në mënyrë profesionale dhe në trajnimin me profile të ndryshme pune. Një tjetër sfidë e re ka të bëjë me romët që kanë migruar në vende të tjera.

Qasje pragmatike për identifikimin e grupeve të synuara

Ky program do t'i përdorë ndërmjetësuesit që kanë lidhje me romët dhe, nëse është e nevojshme, që flasim gjuhën e komunitetit rom me të cilët ata punojnë. **Detyrat dhe përgjegjësitë e tyre përfshijnë lehtësimin e komunikimit ndërmjet romëve dhe një institucioni publik.**

Sfidat në ushtrimin e ndërmjetësimit

Ndërmjetësimi shpesh ka çuar në përmirësime domethënëse, por efektiviteti i tij shpesh sfidohet nga çështje të tilla si statusi i ulët i ndërmjetësuesve dhe punësimi i pasigurt, varësia (tek drejtuesi i institucionit, ndikimi politik, drejtuesit e komunitetit), ose ngarkimi i detyrave të tjera të vogla, të cilat ndonjëherë nuk janë të përfshira në profilin e punës së ndërmjetësuesve. Për më tepër, ndërmjetësuesit mund të përdoren si arsye për të shmangur kontaktin e drejtpërdrejtë me komunitetin, ose priten të marrin mbi supe përgjegjësinë e plotë për zgjidhjen e problemeve. Puna e tyre mund të jetë e përditshme, që kërkon përgjigje, me pak ose me aspak planifikim, me vlerësim jo të vazhdueshëm dhe me mungesë mbështetje për realizimin e detyrave. Faktorë të tillë nënkuptojnë që suksesi varet shumë në cilësitë personale të ndërmjetësuesit dhe në qëndrimet personale të stafit të institucioneve me të cilat punon ndërmjetësuesi.


1. Le terme « Roms » utilisé au Conseil de l'Europe désigne les Roms, les Sintés (Manouches), les Kalés (Gitans) et les groupes de population apparentés en Europe, dont les Voyageurs et les branches orientales (Doms, Loms) ; il englobe la grande diversité des groupes concernés, y compris les personnes qui s'auto-identifient comme « Tsiganes » et celles que l'on désigne comme « Gens du voyage ».

Mund të identifikohen tri lloje qasjesh:

- qasja “Kali i Trojës” (instrument institucioni, misioni i të cilit është të komunikojë me komunitetin me qëllimin e ndryshimit të qëndrimeve dhe të sjelljeve të tij);
- qasja e aktivistit të komunitetit (përfaqësues i komunitetit, i cili lufton kundër institucionit për të drejtat e romëve);
- ndërmjetësuesi i vërtetë ndërkulturor (i cili ka njohuri të mira për “kodet kulturore” të komunitetit dhe të institucionit, është i paanshëm, i përqendruar tek përmirësimi i komunikimit dhe bashkëpunimit, dhe tek stimulimi i të dyja palëve për të marrë përgjegjësi dhe për t'u përfshirë aktivisht në një proces ndryshimi).

Ky program përqendrohet tek nxitja e qasjes së tretë: ndërmjetësimi i vërtetë dhe efektiv ndërkulturor.

Nga “kali i Trojës” ose aktivisti i komunitetit tek ndërmjetësuesi i vërtetë ndërkulturor



Misioni i përcaktuar nga Deklarata e Strasburgut

Në Deklaratën e Strasburgut, miratuar në tetor 2010 në takimin e nivelit të lartë në Romë, përfaqësuesit e shteteve anëtare ranë dakord që Këshilli i Evropës duhet të zbatojë një Program Evropian Trajnimi për Ndërmjetësuesit Romë (ROMED) në mënyrë që të konsolidohen programe ekzistuese të trajnimit dhe që të përdoren më me efektivitete burimet ekzistuese, standardet, metodologjitë, rrjetet dhe infrastruktura e Këshillit të Evropës në bashkëpunim të ngushtë me organet kombëtare dhe lokale.

► Qëllimi i përgjithshëm i ROMED-it:

përmirësimi i cilësisë dhe efektivitetit të punës së ndërmjetësuesve të shkollës/shëndetit/punësimit, me synimin e mbështetjes së një komunikimi dhe bashkëpunimi më të mirë ndërmjet romëve dhe institucioneve publike (shkollës/ofruesve të shëndetit publik/zyrave të punësimit)

► Objektivat e ROMED-it:

- nxitja e ndërmjetësimit të vërtetë dhe efektiv ndërkulturor;
- sigurimi i integritetit të qasjes së bazuar në të drejtat ;
- mbështetja e punës së ndërmjetësuesve me anë të ofrimit të instrumenteve për planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve që inkurajojnë pjesëmarrjen demokratike ndërkohë që prodhojnë fuqizimin e komuniteteve romë dhe rrisin përgjegjshmërinë e institucioneve publike.

ROMED-i nuk zëvendëson ose nuk përsërit programet ekzistuese të trajnimit në nivelet lokale ose kombëtare, por është plotësues i tyre, duke ofruar instrumente dhe metodologji shtesë dhe duke kontribuar për zhvillimin e kompetencave bazë që u nevojiten ndërmjetësuesve. ROMED-i do u vijë po ashtu në ndihmë disa vendeve në krijimin e programeve të trajnimit.

► Kurrikul kuadri:

trajnimi do të bazohet në një kurrikul, e cila përqendrohet fort tek praktika dhe është e përshtatur me nevojat specifike të trajnimit të ndërmjetësuesve që punojnë në kuadër të ndryshme dhe me institucione të ndryshme dhe me komunitetet romë.

► Një Kod Evropian i Etikës për Ndërmjetësuesit

Një kuadër parimesh dhe normash bazë për të drejtuar punën e ndërmjetësuesve është identifikuar si instrumenti kryesor për mbrojtjen e ndërmjetësuesit kundrejt abuzimit dhe për rritjes së cilësisë për shërbimet e ofruara. Është hartuar një draft i parë i frymëzuar nga eksperiencia nga shtete të ndryshme, i cili do t'ju dërgohet ndërmjetësuesve që do të marrin pjesë në trajnime për komente.

► Një skuadër trajnerësh dhe një rrjet evropian:

Grupi i parë i trajnerëve, të cilët u përzgjedhën mbi bazën e një thirrje të hapur, u trajnua në Strasburg nga data 26 deri më 29 janar 2011. Në çdo shtet është identifikuar një pikë kontakti (aty ku ka qenë e mundur është përzgjedhur si pikë kontakti një organizatë romë me eksperiencë në të punuarin me ndërmjetësuesit). Krijimi i rrjetit dhe të mësuarit nga njëri-tjetri do të stimulohen nëpërmjet përdorimit të platformës online.

Grupi i dytë i trajnuesve u trajnua nga data 14 deri më 17 mars 2012.

► Grupi i parë i shteteve përfituese:

Bullgaria, Republika Çeke, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Italia, Moldavia, Rumania, Serbia, Sllovakia, Spanja, “ish Republika Jugosllave e Maqedonisë”, Turqia, Ukraina. Programi do të shtrihet në shtete të tjera në vitin 2012 (në Shqipëri, Belgjikë, Portugali, Federatën Ruse dhe Mbretërinë e Bashkuar) dhe do të ofrohet trajnim shtesë për grupin e parë të shteteve përfituese nëse gjenden burime të tjera shtesë.

Zbatimi i trajnimeve

- **Raundi i parë i trajnimit** (4 ditë). Gjatë ditës së fundit: aktivitete të përbashkëta me aktorët vendorë;
- **Gjashtë muaj praktikë** (zbatimi i qasjeve dhe përdorimi i instrumenteve të prezantuara gjatë trajnimit në punën e përditshme). Aktorët vendorë dhe pikat e kontaktit ofrojnë mbështetje;
- **Raundi i dytë i trajnimit** (3 ditë) dita e parë përqendrohet tek rishikimi i aktiviteteve praktike të zbatuara; rishikimi i arritjeve, përcaktimi i veprimet që do të ndërmerren më pas, përgjigjet e politikave.

Çfarë rolesh luajnë organet?

Këshilli i Evropës

Këshilli i Evropës siguron koordinimin e përgjithshëm të programit nëpërmjet punës së skuadrës mbështetëse të Përfaqësuesit të Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm për Çështjet Rome. Struktura të tjera të Këshillit të Evropës, të tilla si Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale ofrojnë mbështetje. Është përpiluar një kurrikul trajnimi si dhe është përzgjedhur një grup trajnerësh, të cilët janë trajnuar pas konsultimeve me ekspertët e fushës. Përgjatë të gjithë procesit, Këshilli i Evropës mban komunikime të ngushta me organizatat romë aktive në nivelin evropian dhe me organizata të tjera evropiane dhe ndërkombëtare për të siguruar bashkëpunim dhe mbështetje për programin. Programi mund të jetë i suksesshëm vetëm nëse kontribuojnë aktorë të ndryshëm.

Organet në nivelin e pushtetit qendror dhe vendor

- identifikojnë dhe përzgjedhin ndërmjetësuesit që do të trajnohen
- sigurojnë pjesëmarrjen e institucioneve lokale gjatë ditës së fundit të trajnimit dhe i inkurajojnë ato të mbështesin ndërmjetësuesit në nivelin lokal ;
- marrin pjesë në ditën e trajnimit të dedikuar për ndërmjetësuesit dhe organet dhe reflektojnë për përgjigje të mundshme politikash.

Lëvizshmëria ndërkombëtare e romëve është çështje kyçe në punën e ndërmjetësuesve, kështu që bashkëpunimi dypalësh dhe shumëpalësh ndërmjet strukturave në shtetet e origjinës dhe shtetet e destinacionit është një mjet i dobishëm për mbështetje dhe qëndrueshmëri.

Institucionet përkatëse (shëndetësore, shkollë, të punësimit) në nivelin e pushtetit vendor

- marrin pjesë në ditën e fundit të trajnimit të parë sëbashku me ndërmjetësuesit;
- mbështesin ndërmjetësuesit për të realizuar aktivitete praktike bazuar në qasjen e nxitur nga Këshilli i Evropës;
- ofrojnë informacion për bashkëpunimin pikave të kontaktit .

Organizatat romë:

- mbështesin zbatimin e programit në nivelin lokal;
- i japin informacion dhe sugjerime pikave të kontaktit;
- vazhdojnë procesin e vlerësimit dhe identifikimin e sugjerimeve për rregullimin e politikave